

## Plani i Komunikimit dhe Vizibilitetit për vitin 2019

Objektivi	Aktiviteti	Përshkrimi
<p><b>Ndërgjegjësimi i publikut të gjerë mbi efektet e masave antikorrupsion</b></p>	<p>Anketë kundër korrupsionit: Eventi i opinionit publik në bashkëpunim me IT</p>	<p>Për të vlerësuar efektet e masave antikorrupsion të Qeverisë dhe fushatës për rritjen e ndërgjegjësimit për denoncimin e praktikave korruptive do të zhvillohet nga ekspertët e Projektit të Binjakëzimit një anketim me metodën e anketimit online mbi zbatimin e ligjit për sinjalizuesit, së bashku me partneret akademik dhe shoqërinë civile. Anketimi do të kryhet gjithashtu edhe nëpërmjet faqes së internetit të projektit si dhe në faqet partnere. Anketat do të shpërndahen në formë të printuar tek studentët në Universitetet e Tiranës, Shkodrës dhe Vlorës. Gjithashtu do të realizohet dhe një anketim rastësor. Rezultatet e anketës do të përmbillen muajin Prill të vitit 2019.</p>
<p><b>Ndërgjegjësimi i shoqërisë civile dhe të gjithë aktorëve të përfshirë në luftën kundër korrupsionit</b></p>	<p>Forum Konsultativ me tematikë: Konkluzione &amp; hapat e ardhshëm</p>	<p>Aktivitetet do të zhvillohet në muajin Prill 2019. I parashikuar si Forumi i pestë konsultativ, një takim ku do të trajtoheshin praktikatat më të mira, konkluzionet dhe hapat që do të hidhen në vijim. I tillë mund të konsiderohet takimi përmblylës i projektit, pasi aty do të diskutohen tematikat sa më lart, ku do të jenë të pranishëm përfaqësues nga financuesit e Projektit të Binjakëzimit, BE-së, përfaqësues nga institucionet që bashkëpunuan për realizimin e Projektit, përfaqësues nga shoqëria civile vendase dhe rajonale të fushës, ekspertë antikorrupsion, etj. Në këtë takim do të trajtohen të gjitha tematikat e parashikuar për forumin.</p>

Objektivi	Aktiviteti	Përshkrimi
<p><b>Ndërgjegjësimi I brezit të rim mbi politikat e antikorrupsionit dhe përfshirjen e shoqërisë civile në veprimtarinë antikorrupsion</b></p>	<p>Mëngjes Anti-korrupson: takimet rregullisht dhe ne sesionet/edicionet e veçanta</p>	<p>“Në takimin e mëngjesit me studentët e ekselencës që kontribuojnë në Ministrinë e Drejtësisë, për Kodifikimin, Rregullimin e Profesioneve të Lira dhe Politikat Antikorrupsion”. Në datën 27 Shtator, Ministri i Drejtësisë, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit do të zhvillojë takimin e mëngjesit me studentët e ekselencës që kontribuojnë në Ministrinë e Drejtësisë, me fokus politikat antikorrupsion. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe dhe konkretisht në muajin Shtator, nën drejtimin e Ministrit të Drejtësisë do të organizohet një mëngjes pune me përfaqësues nga shoqëria civile, gjatë së cilës do të diskutohet për përfshirjen e tyre në veprimtaritë antikorrupsion.</p>
<p><b>Trajnimi i punonjësve të administratës publike mbi mbështetjen, koordinimin dhe zbatimin e politikave antikorrupsion</b></p>	<p>Komunikimi audio-viziv i trajnimeve administrative mbi anti-korrupsionin</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjatë muajit Shkurt 2019 do të realizohet trajnimi me temë “Anti -Korrupsioni për pikat e kontaktit në institucionet publike”. Ky trajnim do të organizohet nga ASPA në bashkëpunim me Projektin Twinning “Për mbështetjen, koordinimin dhe zbatimin e politikave antikorrupsion në Shqipëri”, financuar nga BE. Në këtë trajnim do të marrin pjesë 11 trajnere për pikat e kontaktit antikorrupsion nga Projekti Twinning “Për mbështetjen, koordinimin dhe zbatimin e antikorrupsionit”.</li> <li>- Gjatë muajit Mars 2019 në datat 4-5 dhe 11-12, në ambjentet e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) do të trajnohen rreth 32 persona, pika kontakti antikorrupsion</li> </ul>

Objektivi	Aktiviteti	Përshkrimi
		<p>lidhur me vleresimin e riskut per korrupsion dhe zbatimin e masave antikorrupsion. - Në datat 28-29 Mars, në ambjentet e hotel Rogner do të realizohet trajnimi me temë “Mjetet për parandalimin e korrupsionit dhe planet e integritetit”. Ky trajnim do të organizohet nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Prezencën e OSBE Tiranë dhe Agjensinë Kombëtare Antikorrupsion të Italisë (ANAC). Në këtë trajnim do të trajnohen rreth 38 nëpunës.</p> <p>- Gjatë muajit Prill 2019 do të realizuohet trajnimi me temë: “Evidentimi i Rreziqeve për Korrupsion (Corruption Proofing)”. Ky trajnim do të organizohet nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Projektin Twinning “Për mbështetjen, koordinimin dhe zbatimin e politikave antikorrupsion në Shqipëri”, financuar nga BE; Trajnimi do të mbahet në datat 16-17-18 Prill (Stafi Antikorrupsion dhe Drejtoria e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë, në datën 18 Prill), në ambjentet e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA). Në këtë trajnim do të trajnohen rreth 73 nëpunës.</p> <p>- Në datën 24 Prill 2019, në ambjentet e MakAlbania Hotel do të organizohet nga ICC Albania (National Committee of the International Chamber of Commerce trajnimi me temë: “Anticorruption”). Nga ky trajnim do të trajnohen rreth 21 persona.</p> <p>- Gjatë muajit Qershor 2019 në datë 3 qershor 2019 do të organizohet nga ASPA trajnimi me temë: “Korrupsioni në administratën publike dhe</p>

Objekti	Aktiviteti	Përshkrimi
<p><b>Mbështetja dhe financimi I donatorëve të huaj dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare për masat antikorrupsion të Planit të Ri të Veprimit 19-23.</b></p>	<p>Takimi kordinues i donatorëve/ Konferencë për shtyp të planit të veprimit</p>	<p>mekanizmat e identifikimit në luftën kundër tij”, i cili do të mbahet në të njëjtin ambient. Në këtë trajnim do të trajnohen rreth 18 persona.</p> <p>Në date 11 Tetor 2019 do të organizohet takimi me partnerë ndërkombëtarë për Planin e Ri të Veprimit Antikorrupsion. Në këtë takim do të prezantohet rezultatet 6 mujore të masave të marra kundër korrupsionit si dhe të objektivave të reja të Planit të ri të Veprimit 2019-2023. Në takim do të diskutohet dhe lidhur me mbështetjen dhe financimin për masat antikorrupsion të Planit të ri të Veprimit 2019-2023. Në këtë takim do të marrin pjesë rreth 29 ambasadorë si dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare.</p> <p>Gjithashtu do të organizohen 2 takime pune me institucionet përgjegjëse për Planin e ri të Veprimit.</p>
<p><b>Përfshirja e të gjithë aktorëve të Planit të Veprimit për diskutimin e masave antikorrupsion.</b></p>	<p>Takim konsultativ për rishikimin e në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale në Luftën kundër Korrupsionit.</p>	<p>Gjatë muajit Shkurt do të organizohet një takim konsultativ duke përfshirë të gjitha institucionet përgjegjëse për masat e përfshira në Planin e Veprimit. Takimi do të ketë për qëllim rishikimin e masave të Planit të Ri të Veprimit 2019-2023 në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale në Luftën kundër Korrupsionit.</p>
<p><b>Konsultime dhe Trajnime mbi masat e Planit të ri të Veprimit 2019-2023 të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit</b></p>	<p>Takime për prezantimin e draftit të ri të Planit të Veprimit dhe kostimin e masave</p>	<p>Gjatë muajit Korrik do të realizohen 6 takime konsultative. Një takim do të organizohet me Grupin Tematik Antikorrupsion/Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit, i cili do të ketë për qëllim prezantimin e draftit të ri të Planit të ri të Veprimit 2019-2023. Pesë takime të tjera</p>

Objektivi	Aktiviteti	Përshkrimi
		teknike do të organizohen në kuadër të trajnimeve mbi koston e masave të Planit të ri të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit.
<b>Diskutimi I masave të Planit të ri të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit</b>	Takime konsultative për përmbajtjen e masave të Planit të ri të Veprimit	Gjatë muajit Gusht dhe Shtator do të organizohen 14 takime teknike konsultative të cilët do të ketë për qëllim diskutimin mbi përmbajtjen e masave të Planit të ri të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit.
<b>Diskutimi I masave të Planit të ri të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit</b>	Takime ndërintucionale sipas qasjeve të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit	Gjatë muajit Nëntor do të zhvillohen tre takime teknike me të gjithë institucionet përgjegjëse për përmbajtjen e masave të Planit të ri të Veprimit 2019-2023. Takimet do të organizohen sipas qasjeve të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit (A-B-C).
<b>Trajnimi për vlerësimin e riskut të integritetit</b>	Takime për vlerësimin e riskut të integritetit në institucionet qendrore dhe planin e integritetit në Ministrinë e Drejtësisë	Gjatë muajit Dhjetor do të zhvillohen 2 takime për trajnimin mbi vlerësimin e riskut të integritetit në institucionet qendrore dhe planin e integritetit në Ministrinë e Drejtësisë.
<b>Ndërgjegjësimi i studentëve të Fakultetit të Drejtësisë</b>	Takim në kuadër të ndërgjegjësimit me studentët e Fakultetit të Drejtësisë	Në muajin tetor, Ministria e Drejtësisë do të zhvillojë një takim ndërgjegjësues me studentët e Fakultetit të Drejtësisë me fokus rolin e GRECO-s në luftën kundër korrupsionit dhe ndërtimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri dhe në vendet anëtare të KE-së. Në takim do të diskutohet mbi GRECO-n si instrument në luftën antikorrupsion dhe ndikimin që rekomandimet kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional në vend për ndërtimin e shtetit të së drejtës.

Objektivi	Aktiviteti	Përshkrimi
<b>Evidentimi i praktikave më të mira antikorrupsion</b>	Trajnim në kuadrin e bashkëpunimit kërkimor me studentët e Universitetit Washington & Lee dhe studentët e Fakultetit të Drejtësisë të Tiranës.	Në muajin nëntor Ministria e Drejtësisë do të organizojë një Workshop në bashkëpunim me Universitetin Washington & Lee dhe Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Workshopi do të fokusohet në praktikat më të mira kundër korrupsionit, në kuadrin e bashkëpunimit kërkimor në kohështrirje disa mujore mes studentëve të dy universiteteve. Stafi i dedikuar antikorrupsion i Ministrisë së Drejtësisë do të angazhohet në plotësim të iniciativës me research mbi strukturat më të mira për të luftuar korrupsionin, si edhe masat që mund të merren në sektorë kyç si arsimi, shëndetësi, pronat dhe prokurimet publike.
<b>Njohja me dokumentat strategjike dhe ndërgjegjësimi i publikut në luftën kundër korrupsionit</b>	Takim me gazetarët në kuadër të luftës kundër korrupsionit	Në muajin dhjetor Ministria e Drejtësisë do të zhvillojë një takim me gazetarët, në fokus të të cilit do të jetë mes pikash të tjera edhe lufta antikorrupsion. Ministria e Drejtësisë do të ndajë me median dokumentat strategjike, arritjet vjetore dhe sfidat që shtrohen në rolin e saj si Koordinator Kombëtar Kundër Korrupsionit.